



KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 16/3 , DATË 4 / 3 /2019

PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “DIVJAKA RESORT ALBANIA”

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti parashikohet të shtrihet brenda Parkut Kombëtar Divjaka – Karavasta dhe prek Zonë Qendrore, Zonë Kreative dhe Zonë të Përdorimit Tradicional. Projekti synon të realizojë një Resort Turistik me sipërfaqe 47.3 Ha, me ndërtesa me lartësi maksimale deri në shtatëmbëdhjetë kate. Duke qenë se tipologjia e projektit nuk përputhet me kategorizimin e zonës, si dhe referuar VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” duhet hartuar Plani i Detajuar i Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDZRK).

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Divjaka Resort Albania”, me subjekt investues Mabetex Group, në Divjakë, ZK. 1492, në procedurën e veçantë, pasi tipologjia e projektit të paraqitur nuk është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe legjislacionin për zonat e mbrojtura.
2. Subjekti ka të drejtë të riaplikojë sërish pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për përfitimin e statusit strategjik nëse ndryshon tipologjinë e projektit dhe e përshtat atë me kriteret dhe veçantitë e zonës.
3. Ngarkohen Institucionet kompetente në zbatim të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” për hartimin e Planit të detajuar të Zonës së Rëndësisë Kombëtare (PDZRK) për

“Zonën Rekreative” të Parkut Kombëtar shpallur me VKM Nr. 687, datë 19.10.2007 ”Për shpalljen, me sipërfaqe të zgjeruar, të ekosistemit natyror Divjakë - Karavasta ”Park Kombëtar”.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

ZËVËNDËSKRYEMINISTËR

ERION BRAÇE

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

BLEDI ÇUÇI

AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ARTUR METANI

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS
SOKOL NANO